

Rellinghauser Str. 22  
45128 Essen

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28

Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29

E-Mail: [info@i-de-al.org](mailto:info@i-de-al.org)

Web: [www.i-de-al.org](http://www.i-de-al.org)

Amtsgericht: Essen VR 5251  
Steuernr.: 112/5870/1294

Bankverbindung: Postbank  
Kontonr.: 999 44 64 35  
BLZ: 360 10 0 43

Präsidentin: Anduena Stephan  
Leitung: Blerina Marku

Essen, am 21.11.2011

## Gjurmë Shqiptare në Gjermani

Shumë të nderuar Miq, shumë të nderuar Miq të Shqipërisë,  
Shkëlqesia Juaj, Zoti Ibrahim, shumë e nderuar Znj. Musliu, Sekretare e  
Parë e Ambasadës së Republikës së Kosovës,

një falenderim i vecantë për Ju, që sot na nderoni me prezencën Tuaj  
IDEAL – Shoqatën Integrative Gjermano Shqiptare.

IDEAL ndoshta shoqata më e re ne diasporën shqiptare në Gjermani  
është pasqyra e ndërthurjes së origjinave, të profesioneve dhe  
eksperiencave të jetës së dy kombeve, atij shqiptar dhe atij gjerman.

Rrugët tona të përbashkëta janë kryqezuar shpesh në dy shekujt e fundit  
por që nga vitet 60 kur qytetarët e parë të Kosoves u vendosën në  
Gjermani për të mbështetur zhvillim ekonomik të Gjermanisë së pas  
luftës me punën e tyre dhe sidomos këtu në landin e Vestfalisë së Veriut  
u hodhën themelet e diasporës sonë.

Në këto 20 vitet e fundit, sidomos pas rënies së sistemit diktatorial ne  
Shqipëri dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, Gjermania u bë atdheu  
i dytë për një brez të rinj shqiptarësh të cilit i përkasim dhe shumë nga ne

këtu sot.

Shumë nga ne kanë studiuar apo vazhduar studimet këtu, janë sot filologë, shkrimtar, mjek, ekonomistë, muzikatë, inxhinierë, arkitektë, mësues, teknike të shkëlqyer dhe sipërmarrës të suksesshëm. E parë në këtë këndvështrim, çdo kush mund të thotë se ne shqiptarëve që sot jemi qytetarë të Gjermanisë, që jetojmë dhe punojmë këtu, asgjë nuk na mungon!

Por ka diçka që na mungon të gjithëve: bota jonë shqiptare, ndjenja e përkatësisë së origjinës, një copëz Tiranë a Prishtinë me jetën e saj pa andralla, një kafe mediterane ku flisim kaq shumë për miqtë e shokët, për artin e politikën... kjo na mungon të gjithëve!

IDEAL – është produkt i kësaj jete ende të paplotësuar tërësisht në këte atdhe të dytë. E ndërsa flisim me njëri tjetrin nëse me krijim e një shoqate të re do të arrijmë të lëvizim diçka, nuk e patëm të vështirë të gjenim përgjigjen e asaj që kërkonim: Ne të gjithë kemi mësuar e përjetuar shumë, tani ne duam ta ndajmë këtë eksperiencë me Ju me shqiptarët që jetojnë këtu, por dhe me miqtë tanë gjermanë që na shoqërojnë gjithkund. Dhe më tej, ne duhet të përcjellim vlerat tona tek fëmijët tanë.

Dhe a do t'ia dalim dot mbanë? Sikurse thotë dhe Bob Ndertuesi në filmin aq të dashur për të gjithë fëmijët tanë: Po! Ne do t'ia dalim! Por së bashku!

Dhe ja ku jemi sot si IDEAL – Shoqata Integrative Gjermano Shqiptare, shoqatë e rregjistruar zyrtarisht në rregjistrin e shoqatave në Essen dhe sot këtu mes jush e dukshme dhe e degjueshme. Shumë shoqata angazhohen intensivisht për Shqipërinë dhe të gjithë shqiptarët, disa shoqata më shumë në aspektin kulturor, disa në atë social e të tjera në atë sportiv. Dhe kanë arritur të bëjnë shumë.

Por IDEAL i është dedikuar temave të Integracionit, Kulturës, Ekonomisë dhe Bashkëpunimit bilateral. Për ne, pa arritur një integrim ku të dy palët e shikojnë njëri tjetrin si të barabartë nuk mund të arrihet një shkëmbim i suksesshëm kulturor dhe social, pa një bashkëpunim të ngushtë nuk mund të rrihen suksese në fushën ekonomike, qoftë këtu ku jetojmë qoftë dhe në kuadrin bilateral mes dy vendeve tona.

Ndoshta këndvështrimi ynë tingëllon paska IDEAL.ist, por Europa e sotme, arriti të bëhej një Bashkësi kulturore, ekonomike dhe sociale nga më të zhvilluarat në botë nga kontributi i idealistëve të saj rilindës. Ne jemi optimist!

Për IDEAL është e qartë se efektiviteti i aktiviteteve tona arrihet vetëm atëherë kur IDEAL nuk punon e lufton e vetme si shoqatë për realizimin e objektivave të saj, por bashkëpunon me simotrat e saj si dhe me institucionet përkatëse si ato gjermane dhe ato shqiptare. Në këtë kontekst, dhe një herë shpreh falenderimin tim për mbështjetjen që na ka dhënë Ambasada Shqiptare, ju falenderoj Z. Ambasador Ibrahim. Ju falenderoj gjithashtu dhe Ju Znj. Musliu dhe Ambasadës së Republikës së Kosovës për vëmendjen që na keni kushtuar. Një falenderim i vecantë dhe Shoqatës „Vetëvendosja“ për përkrahjen e madhe. Faleminderit Bashkim!


Ju me siguri e keni parë broshurën tonë, dhe ndoshta e keni vëzhguar kubin mbi faqen e parë pak më gjatë: Kubi mbi të cilin harmonizohen aq bukur simbolet shqiptare dhe gjermane dallohet qartë. Por atij ende i mungojnë disa pjesë, që të jetë perfekt.

IDEAL dëshiron të japë kontributin e saj për të plotësuar këto pjesë që mungojnë për të krijuar kështu një kub të plotë dhe të mirë integruar. Sonte, themi se kemi bërë dicka për të shtuar dhe një copëz në të. Ju do të përjetoni një shembull të bashkëpunimit të ndërsjelltë nëpërmjet performancës së artistëve tanë. Disa prej tyre janë anëtarë aktiv të IDEAL, disa të tjerë mbështetës të zjarrtë. Dhe ata nuk janë vetëm shqiptarë, janë gjerman, grekë, turq, ata të gjithë së bashku janë Europiane!

Migen, Fatmir, Etleva, Blerina, Dorina, Genti, Kadir, Jola, Arjan dhe gjithë anëtarëve të tjerë dhe mbështetasve tanë: Faleminderit. Kështu dëshirojmë të punojmë dhe të performojmë dhe në të ardhmen! Së bashku

Por puna jonë do të quhej e pambaruar nëse nuk sigurojmë që të tjerët e marrin stafetën në dorë dhe e vazhdojnë këtë kontribut në vitet që do të vijjnë. Për këtë arsye, IDEAL i kushton një vëmendje tepër të vecantë fëmijëve, brezit që lindi apo u rrit në Gjermani.

Qëllimi ynë është i qartë: Ne kemi se çfarë të transmetojmë tek ata. Është NDER të jesh Shqiptar, ashtu sic është NDER të jesh dhe Gjerman, por është një shanc unikal që fëmijët tanë janë trupëzimi i dy kulturave dhe traditave kaq të vyera. Ne dëshirojmë që fëmijët tanë t'i



pasurojnë këto tradita së bashku me shokët e tyre europiane dhe t'i përcjellin ato më tej. Kjo është pjesë e përkushtimit tonë. Me këtë rast një falenderim të përzemërt dhe fëmijëve të IDEAL, që sot me dëshirën të madhe do të na mbështesin dhe do të përfaqësohen.

Dhe së fundi një fjalë për ditën e Hënë: Në këtë ditë në të gjithë Shqipërinë dhe Kosovën por dhe në pjesë të Maqedonisë dhe Malit të Zi ku jetojnë shqiptarët ashtu si dhe në të gjithë diasporën tonë në të gjithë botën do të festohet 28 Nëntori 1912. Kjo është dita kur flamuri ynë i kuq me shqiponjën krenare u valëvit i lirë.

Le të festojmë sot së bashku një pjesë Shqipëri në këtë vend të mrekullueshëm ku jetojmë, Gjermaninë.

Faleminderit

Anduena Stephan